



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI I BASHKISË MEMALIAJ

Nr. 681 prot.

Memaliaj më 25.03.2025

Procesverbal

I mbajtur sot më datë 25.03.2025 në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në katin e parë të Bashkisë Memaliaj.

Mbledhja drejtohet nga kryetari i këshillit bashkiak Z. Erjon Sinanaj.

Mbledhja fillon në orën 10:30.

Këshilltarë të pranishëm 9 këshilltarë në momentin e fillimit të mbledhjes.

Të pranishëm nga administrata: Shahin Hoda/ specialist i bujqësisë Besnik Caushi/ Drejtor finance, Laora Hoxha/Përgjegjëse e shërbimit social, Xhuvana Kuçi/ Juriste.

Në mbledhje e pranishme është dhe znj. Margarita Çibuku e cila kërkon rishqyrtimin e VKB nr.6 datë 27.01.2025 "Për pasqyrimin e detyrimit financiar për subjektin Margarita Sh.p.k që rrjedhë nga kontrata me datë 01.09.1997 me objekt: "Sipërmarrjen e mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbëruara, mirëmbajtjes së varrezave publike dhe dekorit" në periudhën 01 Janar-31 Tetor 2002 ne vlerën 3,200,000 (tre million e dyqind mije) lekë".

Erjon Sinanaj/Kryetar këshilli: Pasi të na vij dokumentacioni do t'ju vëmë në dijeni.

- Pika e parë e rendit të ditës: "Miratimi i rendit të ditës.

Njohja me rendin e ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 27.02.2025.
3. Informacion mbi vendimet e marra në mbledhjen së datës 27.02.2025.
4. Informacion mbi përballimin e emergjencave civile gjatë vitit 2024 si dhe masat e marra për vitin 2025".
5. **Projekt vendim:** "Për dhënien e ndihmës ekonomike (fondi i kushtëzuar 6% i bllok-ndihmës ekonomike) për periudhën 1-28 shkurt 2025".
6. **Projekt vendim:** "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin mars 2025".
7. **Projekt vendim:** "Për miratimin e sipërfaqes së tokës bujqësore që do të jepet me qera"
8. **Projekt vendim:** "Për miratimin e Planit Operacional vjetor të Bashkisë Memaliaj për vitin 2025".

9. **Projekt vendim :** " Për miratimin në parim për rritjen e numrit me 6(gjashtë)punonjës të strukturës së Sektorit të MZSH-së Bashkia Memaliaj. "

10. **Projekt vendim:** "Për dhënie ndihmë financiare Znj.Dallëndyshe Shehu".

11. **Projekt vendim:** "Për dhënie ndihmë financiare Z.Sihat Mala".

12. **Projekt vendim:** "Për dhënie ndihmë financiare Znj.Sanije Saka".

13. **Projekt vendim:** "Për dhënie ndihmë financiare Z.Edmond Nano".

14. **Projekt vendim:** "Për dhënie ndihmë financiare Znj.Alije Hyseni".

15. **Projekt vendim:** "Për dhënie ndihmë financiare Znj.Florida Kuro".

16. **Projekt vendim:** "Për dhënie ndihmë financiare Z.Kadri Hima".

17. **Projekt vendim:** "Për dhënie ndihmë financiare për dëmshpërblim nga fatkeqësitë natyrore " . Z.Esmerald Xhemali: Për procedurë ,komisioni i financës ka një vakancë ,duhet zëvendësuar ,pasi nuk mund të mblidhet .Unë propozoj të shtojmë në rend dite 1. Relacionin "Për dhënie ndihmë financiare Znj.Tariko Gaxhi". 2. Relecionin "Për shlyerje detyrimi" që ka ardhur zyra juridike, të futen në rend dite.

Kryetari e hedhim në votim rendi i ditës duke shtuar pikën e parë 1. Relacionin "Për dhënie ndihmë financiare Znj.Tariko Gaxhi".

Vota Pro 8 vota

Vota Kundër 0 vota

Vota Abstenim 0 vota . Miratohet. Arsola Muzha nuk merr pjesë në votim.

Kryetari e hedhim në votim rendi i ditës duke shtuar pikën e dytë. Relecionin "Për shlyerje detyrimi"

Vota Pro 2 vota

Vota Kundër 0 vota

Vota Abstenim 0 vota. Nuk Miratohet. Arsola Muzha nuk merr pjesë në votim.

●Pika e dytë e rendit të ditës " Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar ".

Hidhet në votim.

Vota Pro 7 vota

Vota Kundër 1 Vota E. Xhemali

Vota Abstenim 0 votë. Miratohet.

●Pika e tretë e rendit të ditës.

Informacion mbi vendimet e mbledhjes së datës 27.01.2025 sipas shkresës nr.230/1 prot. datë 11.03.2025

●Pika e katërt e rendit të ditës.

Informacion mbi përballimin e emergjencave civile përgjatë vitit 2024.

●Pika e pestë e rendit të ditës. **Projekt vendim:** "Për dhënien e ndihmës ekonomike (fondi i kushtëzuar 6% i bllok-ndihmës ekonomike) për periudhën 1-28 shkurt 2025".

Relaton Laora Hoxha sipas relacionit bashkangjitur.

Hidhet në votim.

Vota Pro 8 vota

Vota Kundër 1 vota E. Xhemali

Vota Abstenim 0 vota. Miratohet.

●Pika e gjashtë e rendit të ditës. **Projekt vendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin mars 2025”.

Relaton Laora Hoxha sipas relacionit bashkangjitur.

Hidhet në votim.

Vota Pro 8 vota

Vota Kundër 1 vota E. Xhemali

Vota Abstenim 0 vota. Miratohet.

●Pika e shtatë e rendit të ditës. **Projekt vendim:** “Për miratimin e sipërfaqes së tokës bujqësore që do të jepet me qera”.

Relaton Z.Shahin Hoda sipas relacionit bashkangjitur.

Z:Flamur Mushamati: A ka konflikt me banorë të zonës?

Z.Shahin Hoda: Jo nuk ka konflikt, pasi unë jam dhe vet banor i zonës.

Z.Asqeri Muçoima: Ku ndodhet në terren?

Z.Shahin Hoda: E kam hartën bashkangjitur . Është e garantuar që nuk ka pronar janë dhe dokumentet verifikuese nga institucionet përkatëse.

Z.Asqeri Muçoima: Kush i ka bërë kërkesat? Përsa vjet jepet me qera? Apo shpallet ankand?

Z.Shahin Hoda: Kërkesat janë nga disa qytetar. Jepet me qera për 30 vjet për pemë frutore ose 99 vjet kur janë ullinj, jmosha e të cilëve kalo 100 vjet.

Edmonda Harizi:Për këto toka kanë ardhur më parë kërkesa apo është hapur ankand?

Z.Shahin Hoda: sipas procedurës do të jepen me qera pasi të jenë miratuar nga këshilli në parim.

Irena Jaupi: Ju sapo thatë që janë mbiell ullinj dhe po bini në kundërshtim .A e lejon ligji të bëhet një plan biznesi pasi kjo është e mjellë ullinj.

Z.Shahin Hoda:Një nga parcelat është e mbiell ullinj.

Znj.Xh.Kuçi: Statusi i tokës është shtet.

Z.Esmerald Xhemali:Për këto tokat me qera që bashkia i jep për të maksimizuar të ardhurat .Ne kemi dhënë toka me qera kur dokumentat ika sjellë bashkia, nëse nuk janë të sakta mos i pranoni . Kur ti regjistroj bashkia si prona atëherë ti jap. Ka certifikatë pronësie që janë pronë e bashkisë ?

Hidhet në votim.

Vota Pro 1 vota . F.Mushamati

Vota Kundër 8 vota

Vota Abstenim 0 vota. Nuk miratohet.

●Pika e tetë e rendit të ditës. **Projekt vendim:** “Për miratimin e Planit Operacional vjetor të Bashkisë Memaliaj për vitin 2025”.

Relaton Z.Shahin Hoda sipas relacionit bashkangjitur.

Z:Esmerald Xhemali:Në plan thoni Brenda muajit shkurt do të përgatitet plani për çdo njësi .A I keni planet për çdo njësi?

Z.Shahin Hoda: Nuk kam dijeni.

Kryetari këshillit:Nuk Ka më diskutime e hedhim në votim .

Vota Pro 1 vota . F.Mushamati

Vota Kundër 6 vota

Vota Abstenim 2 vota. L.Lila E.Sinanaj.Nuk miratohet.

●Pika e nëntë e rendit të ditës. **Projekt vendim :** " Për miratimin në parim për rritjen e numrit me 6(gjashtë)punonjës të strukturës së Sektorit të MZSH-së Bashkia Memaliaj."

Relation Xh.Kuçi sipas relacionit bashkangjitur.

Diskutime: A.Muçoima:Ne thamë dhe herën e kaluar që të bëhet kërkesë në ministrinë e financës.

Xh.Kuçi: Kërkesën e kemi gati por duhet dhe miratimi i këshillit bashkangjitur për çështje procedurale.

Znj. Lauresha Lila: Në zonën ku unë banjo ra zjarr para disa kohësh. Ata punonjës që janë erdhë në kohë record , por nuk kishin çfarë I bënin në atë terren të thepisur.Unë mendoj të shtohet numri i punonjësve.

Afize Sula: A I kanë kushtet këta 14 punonjës për të qenë efektiv në rast emergjence. A ka një raport që këta janë të gatshëm , por nuk kanë kushte?

Z.Besnik Caushi: Këto kanë ngarkesë se duhet të punojnë orë shtesë.sa për kushtet I kanë veshjet përkatëse.

Edmonda Harizi: Kanë marrë orë shtesë se kanë mungesë në burime njerëzore?

Asqeri Muçoima:Ky është një fond i deleguar nga ministria .A I ka të ndarë sa punonjës dhe sa orë shtesë ?

Xhuvana Kuçi: Nuk kemi pasur një indicia deri më sot . Sot nga analiza e bërë dolëm në përfundimin e shtimit të punonjësve.

A.Muzha: po e krahasoj me fushën e arsimit kur ikën një mësues i ngarkohen mësuesit tjetër dhe ai mësues kalon në stress për shkak të ngarkesës në punë.Unë u mbështes për të miratuar këtë p/vendim për të patur punë më efikase.

Hidhet në votim.

Vota Pro 8 vota

Vota Kundër 1 vota I.Jaupi.

Vota Abstenim 0 vota. Miratohet.

Asqeri Muçoima: Sqaroj votën time ,do të keni monitorim për këtë çështje.Nuk do të jem në mbështetje të kërkesave të bashkisë pa vënë dorë në rrugën e fshatit Zoç.

Largohet nga mbledhja ZNj.Irena Jaupi.

Kryetari I këshillit propozon të kalojnë në bllok p/vendimete për ndihmë financiare.

Projekt vendim: “Për dhënie ndihmë financiare Znj.Dallëndyshe Shehu”.

Projekt vendim: “Për dhënie ndihmë financiare Z.Sihat Mala”.

Projekt vendim: “Për dhënie ndihmë financiare Znj.Sanije Saka”.

Projekt vendim: “Për dhënie ndihmë financiare Z.Edmond Nano”.

Projekt vendim: “Për dhënie ndihmë financiare Znj.Alije Hyseni”.

Projekt vendim: “Për dhënie ndihmë financiare Znj.Florida Kuro ”.

Projekt vendim: “Për dhënie ndihmë financiare Z.Kadri Hima”.

Projekt vendim: “Për dhënie ndihmë financiare Znj.Tariko Gaxhi”.

Hidhet në votim.

Vota Pro 8 vota

Vota Kundër 0 vota

Vota Abstenim 0 vota. Miratohet.

●Pika e tetëmbëdhjetë e rendit të ditës. **Projekt vendim:** “Për dhënie ndihmë financiare për dëmshpërblim nga fatkeqësitë natyrore “ .

Nuk ka diskutime .

Hidhet në votim.

Vota Pro 8 vota

Vota Kundër 0 vota


Vota Abstenim 0 vota. Miratohet.

Kryetari i këshillit e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Këshilltarë pjesëmarrës.

1. Afize Sula
2. Arsola Muzha
3. Esmerald Xhemali
4. Asqeri Muçoima
5. Edmonda Harizi
6. Lauresha Lila
7. Erjon Sinanaj
8. Flamur Mushamati

Sekretari i Këshillit
Erjola Allka



Kryetari i Këshillit
Erjon Sinanaj